

2009-2010: *“Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit e kualifikimit shkencor për degët e Inxhinierisë në Univerisitetin Politeknik të Tiranës me ngritjen dhe funksionimin e Laboratorit të Kimisë së Përgjithshme dhe Inorganike”*. Projekti u hartua dhe realizua, në Kuadrin e Programit Kombëtar për *“Barazinë dhe Cilësinë e Arsimit të Lartë”*. Në kuadër të këtij projekti u mundësua ngritja pranë Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike e Laboratorit të Kimisë, të pajisur me mjetet laboratorike dhe pajisje bazë. Ky laborator j’u shërben të gjithë studentëve të viteve të para të Ciklit Bachelor në Fakultetet e UPT-së, të cilët zhvillojnë pranë këtij laborator praktikat e tyre laboratorike në përputhje me bazë të programeve mësimore. Po ndërkohë ky laborator i mundëson stafit akademik të Departamentit të Kimisë të kryejnë një pjesë të punës të tyre kërkimore shkencore, kryesisht në fushën e monitorimit mjedisor.



2011-2012: *“Vlerësimi i ndotjes së mjedisit në një zonë urbane të lumit Lana, Tiranë”* Projekti është financuar nga Qeveria Shqiptare në kuadrin e Programit Kombëtar të Kërkimit dhe Zhvillimit - *“Për Kërkime Themelore dhe Ekselencë”*. Në kuadër të këtij projekti u realizuan aktivitetet e mëposhtme:

- *Identifikimi i burimeve kryesore të ndotjes së ajrit dhe ujit në zonën në studim;*
- *Matja e përqendrimeve ditore të lëndës së grimtuar 10 mikronëshe (PM₁₀) pranë kryqëzimit “Vasil Shanto” për një periudhë 1 vjeçare, si dhe studimi i ndikimit të faktorëve meteorologjikë dhe ndryshimeve stinore në situatën e ndotjes së ajrit nga PM₁₀.*
- *Matje e parametrave fiziko-kimike të ujit në Lumën Lana në pikën pranë kryqëzimit “Vasil Shanto”.*



Përveç analizës kimike dhe monitorimit të ujërave të ndotura dhe ajrit urban në zonën në studim, në kuadër të këtij projekti u realizua përgatitja dhe mbrojtja e dy tezave diplome për gradën Master i Shkencave.

2013-2014: “Vlerësimi i impaktit të veprimtarive ekonomike në cilësinë e ujit të Lumit të Erzenit”. Ky projekt u realizua me bashkëfinancim nga CEI-KEP Austria dhe si bashkëpunim midis Departamentit të Kimisë në UPT dhe Institutit të Inxhinierisë Sanitare dhe Kontrollit të Ndotjes së Ujrave të Universitetit Burimeve Natyrore dhe Shkencave Jetwsore (*Institute of Sanitary Engineering and Water Pollution Control, -University of Natural Resources and Life Sciences – BOKU*). Ndër arritjet kryesore të këtij projekti janë:


- *Forcimi dhe përmirësimi i kapaciteteve teknike të Departamentit të Kimisë për kryerjen e studimeve në fushën e monitorimit mjedisor, në veçanti, të cilësisë të ujrave sipërfaqësore;*
- *Shkëmbimi i njohurive në fushën e menaxhimit të cilësisë të ujrave;*
- *Fuqizimi i kapaciteteve shkencore të stafit të Departamentit të Kimisë në kryerjen e analizave laboratorike dhe matjeve në terren;;*
- *Zbatimi i Standardeve Europiane në analizat kimike në laborator, përfshirë Sigurimin dhe Kontrollin e Cilësisë së Analizave.*



2015-2017: “Një studim përqasës i sistemit të monitorimit të ujrave në Shqipëri. Vlerësimi i gjendjes dhe dhe identifikimi i nevojave në këndvështrimin e Direktivave të Bashkimit Evropian”. Ky projekt u mundësua në kuadër të Marrëveshjes bilaterale për Bashkëpunim Shkencor dhe Teknologjik midis Republikës së Shqipërisë dhe Austrisë dhe është financuar nga AKTI. Projekti u realizua në bashkëpunim me Institutin e Inxhinierisë Sanitare dhe Kontrollit të Ndotjes së Ujrave të Universitetit Burimeve Natyrore dhe Shkencave Jetësore (*Institute of Sanitary Engineering and Water Pollution Control - University of Natural Resources and Life Sciences – BOKU*). Në kuadër të këtij projekti u synua:

- Krijimi i një tabloje të përgjithshme mbi eksperiencat shkencore, institucionale dhe praktike në dy vendet partnere në fushën e menaxhimit të burimeve ujore;
- Bashkërendimi i përvojës së institucioneve partnere për menaxhimin dhe përmirësimet e nevojshme në fushën e kontrollit të ndotjes së ujit, duke pasur si referencë Direktivën Kuadër të Ujit në BE (WFD), si dhe praktikatat më të mira Austriake.
- Hartimi i rekomandimeve mbi implementimin dhe zbatimin e legjislacionit të BE dhe përballjen me sukses të sfidave që kanë të bëjnë me kontrollin e ndotjes së ujit në Shqipëri ;
- Hartimi i rekomandimeve për krijimin e një sistemi plotësisht operacional të Menaxhimit të Integruar të Ujit në Shqipëri.
- Hartimi i rekomandimeve në lidhje me forcimin dhe përmirësimin e sistemit të edukimit dhe trainimit në fushën e menaxhimit të ujit;

Projekti mundësoi vizitat studimore të ndërsjella të studentëve shqiptarë dhe austriakë, si dhe përgatitjen dhe mbrojtjen e 3 punimeve të diplomave në përmblyllje të studimeve të ciklit të dytë “Master Shkencor”.



2016: OpenLab ALBANIA, shkolla e parë e kristalografisë, aktivitet që u zhvillua në datat 30 Maj – 3 Qershor 2016, në bashkëpunim me Institutin e Kristalografisë së Qendrës së Kërkimit Kombëtar në Itali. Ky aktivitet ndërkombëtar, ku morën pjesë personel akademik, post-doktorantë, doktorantë, studentë të bachelorit e masterit të UPT, UT dhe UM, si dhe nga rajoni, Kosova dhe Maqedonia, u realizua si bashkëpunim i UPT/FIMIF me Unionin Ndërkombëtar të Kristalografisë dhe UNESCO, ndërsa Bruker Cooperation mundësoi sjelljen e një difraktometri monokristal AXS SMART X2S. Financimi i aktivitetit u realizua nga IUCr dhe UNESCO.



Polytechnic University of Tirana
Faculty of Mathematical Engineering and Physical Engineering

CRYSTALLOGRAPHY SCHOOL



An initiative of the International Union of Crystallography and UNESCO
in partnership with Bruker Corporation

Tirana, 30 May - 3 June 2016

The IUCr-UNESCO OpenLab is a network of operational crystallographic laboratories based in different countries worldwide. They are aimed at allowing access to crystallographic knowledge and technology in all parts of the world, key for the fruitful development of science, and to open possibilities for conducting high-level research. The IUCr-UNESCO OpenLab Albania is the first OpenLab for South-East Europe and the Balkan region.

It follows the success of the events organized in Albania during the **International Year of Crystallography 2014** namely the International Conference "New Frontiers of Nanomaterial Technologies for Applications in Biology and Medicine" and the "1st Workshop on Crystallography", which was held in conjunction with the 20th Congress of the Carpathian-Balkan Geological Association.



Main Lecturer




Prof. Gervais Chapuis
École Polytechnique
Fédérale de Lausanne,
Switzerland

Organizing Committee

Michele Zema, University of Pavia, Italy and IUCr, UK, IUCr representative, *Chair*
Dritan Siliqi, IC-CNR, Italy, *Co-chair*
Enkeleida Beqiraj, Polytechnic University of Tirana (PUT), Albania, *Co-chair*
Jean Paul Ngome Abiaga, UNESCO representative
Carl Henrik Görbitz, University of Oslo, Norway, *ECA representative*
Altin Mele, University of Tirana (UT), Albania
Anila Bulo, University of Medicine (UMED), Albania


Local Organizing Committee

Bujar Dida, FIMIF-PUT, *Chair*
Raimonda Totoni (Lilo), FIMIF-PUT, *Co-chair*
Albana Jano, FIMIF-PUT, *Secretary*
Edlira Baraj, FIMIF-PUT, *Member*
Edlira Tako, FIMIF-PUT, *Member*



bruker AXS SMART X2S
single-crystal diffractometer
available at the OpenLab
for demonstration
and data collection

SPONSORS



2018-2020: “Sintetizimi dhe karakterizimi i nanomaterialeve të reja me qëllim përdorimin e tyre në restaurimin dhe mirëmbajtjen e fasadave të objekteve të klasifikuara si monumente kulturore”

Projekti u mundësua nga AKKSHI (Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit) për Shqipërinë dhe CNR (Consiglio Nazionale delle Ricerche) Këshilli Kombëtar i Kërkimeve Shkencore të Italisë, zbatuar nga UPT në vendin tone dhe nga Instituti i Kristalografisë në Bari,, paraqet një analizë teorike të mbrojtjes dhe konservimit të trashëgimisë kulturore të gurit, të mbështetur edhe në legjislacionin përkatës të Evropës dhe vendit tonë, sintezën dhe karakterizimin e nanomaterialeve të grupit të tokave alkaline, optimizimin e prodhimit eksperimental dhe analizën e detajuar të mbrojtjes së traventinave, duke krijuar një bazë për kuptimin e natyrës së realizimit të konsolidimit me nanomateriale dhe strategjive që duhen ndjekur për realizimin e saj. Në llojin e tij, studimi synon një qasje inxhinierike të bazave të realizimit të mbrojtjes dhe konsolidimit të trashëgimisë kulturore të gurit, në këndvështrimin e shikimit të procesit si fenomen që mund të zbatohet në praktike gjerësisht apo i kufizuar.

Në përfundim, studimi u botua si editorial me titull “*Nanomaterialet për Konservimin e Trashëgimisë Kulturore*” që u shkrua për të mundësuar përhapjen e studimit, punës shkencore eksperimentale dhe përpunimin e rezultateve me metodat bashkëkohore që përdoren sot për nanomaterialet.

[Botimi i plotë në pdf mund të shkarkohet në faqen](#) e UPT, ndërsa kopje të tij gjenden në Bibliotekën Kombëtare me ISBN 978-99943-2-468-2, si edhe në Bibliotekën e UPT.

